



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	10.10.2022 01-011/01-22744
Për:	Arbëneshë Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit me nr. 01-011-78400 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – “Tregu në Orize”


Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 41 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datën 26.12.2008, Kryetari i Komunës së Gjakovës e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratoj vendimin për shfuqizimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – “Tregu në Orize” me numër 01-011-78400 të datës 26.05.2022.
2. Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale – “Tregu në Orize” propozohet të shfuqizohet për shkak se në njoftimin publik të shpallur nga Komisioni Vlerësues me numër 01-463/02-19917 të datës 10.08.2022, nuk ka pasur të interesuar për të marrjen në shfrytëzim të pronës komunale - Tregu në Orize.
3. Komuna e Gjakovës në bazë të nenit 26 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ka dhënë në shfrytëzim pronën komunale – Tregu në Orize institucionit vartës, përkatësisht Ndërmarrjes Publike K.R.M “Çabrat”, në afat prej dy vitesh.

Me respekt!



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 26.05.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6, 7, 8 dhe 14 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2022 pas diskutimit lidhur me pikën 4 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale- Tregu në Orize , e miratoi këtë:

V E N D I M

Paraparak për

Dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të Pronës së Paluajtshme Komunale “Tregu në Orize “ në pjesën e parcelës me numër 5127-3 me sipërfaqe prej 1100 m² Z.K Gjakovë J Qytet, në pronësi të Komunës së Gjakovës
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale “Tregu në Orize “ është afatshkurtër në kohëzgjatje prej një (1) viti .
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale “Tregu në Orize” të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është funksionalizimi dhe përfitim Ekonomik i Komunës nga Pronat Komunale .
- 4.Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënin në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës